



BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND
HANSESTADT WISMAR

Nr _____ Prot, Datë 25.04.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr 3484 Prot, Datë 25.04.2019

**MARRËVESHJE
MBI THEMELIMIN E NJË BINJAKËZIMI**

NDËRMJET

**BASHKISË WISMAR
REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË**

DHE

**BASHKISË POGRADEC
REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

I. QËLLIMI

Me synimin për të përmirësuar komunikimin në mes të, njerëzve, qyteteve, bashkive dhe shteteve si dhe me qëllim dhënien e kontributit për promovimin e Europës dhe idesë Europiane, bashkia Wismar, Republika Federale e Gjermanisë dhe bashkia Pogradec, Republika e Shqipërisë, do të lidhin një marrëveshje mbi binjakëzimin dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

II. FUNKSIONI

Të dyja palët do të bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre, për të promovuar dhe forcuar partneritetin dhe bashkëpunimin për mes kontaktit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet qytetarëve, shoqatave dhe organizatave si dhe kompanive në fushën ekonomike, turistike, kulturore, sociale dhe politike.

III. VEPRIMTARIA

Në fushën kulturore, të dyja palët do të mbështesin vecanërisht shfaqjet muzikore, shfaqjet teatrore si dhe ekspozitat.

IV. PROMOVIMI

Në fushën e ekonomisë dhe atë të turizmit, të dyja bashkitë do të promovojnë bashkëpunimin e organizatave përkatëse, duke ndihmuar në ndërmjetësimin e kontakteve dhe të projekteve.

V. SHKËMBIMI I PËRVOJËS

Në fushën e administratës, palet bien dakort për një këmbim të vazhdueshëm përvojash, veçanërisht, mbi çështjet që kanë të bëjnë me dixhitalizimin ose me masat e mbrojtjes kundër zjarreve ose në rast katastrofash.

VI. RINIA

Të dyja palët në mënyrë të veçantë do të promovojnë këmbimin mes të rinjve dhe nxënësve. Për të realizuar këtë, do të inkurajohen veçanërisht shkollat, por gjithashtu shoqatat e qyteteve perkates.

VII. TRANSPARENCA

Qytetarët e të dyja bashkive duhet të informohen sa më mirë dhe në mënyrën më të plotë të mundshme nëpërmjet shtypit, radios dhe televizionit mbi qytetin partner të binjakëzuar dhe mbi shtetin tjetër, duke i inkurajuar ata që të vizitojnë qytetin partner.

VIII. HYRJA NË FUQI

Që të hyjë në fuqi kjo marrëveshje, duhet konfirmimi ose lejimi nga institucionet përkatëse të të dyja bashkive Wismar / Pogradec.

PËR BASHKINË WISMAR

KRYETARI I BASHKISË

THOMAS BEYER



PËR BASHKINË POGRADEC

KRYETARI I BASHKISË

EDUART KAPRI

